



Raport vjetor 2018



www.insig.com.al

Shqipëri

Rruga “Jul Variboba” Nr. 21 , Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 42 400 792 ,

Fax: +35542400800 ,

E-mail: info@insig.com.al

Raport vjetor

2018

Përmbajtje

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm	5
Zhvillime kryesore	6
Përgjegjësia sociale	8
Pronësia mbi kompaninë	9
Organizimi i kompanisë	10
Organigram	10
Treguesit financiarë	11
Dëme të paguara	12
Opinion i audituesit të pavarur	16
Pasqyrë e humbjeve dhe e të ardhurave të tjera	22
Përmbledhëse të INSIG sh.a.	23
Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike	24
Shënime mbi pasqyrat financiare	24
Raport (përmbledhje)	27



Të nderuar Miq dhe Klientë të INSIG!

Ndihem e nderuar që përmes këtyre pak rreshtave të mund të ndaj me ju sfidat dhe arritjet e shoqërisë INSIG sh.a përgjatë vitit 2018 si pjesë e industrisë së sigurimeve në Shqipëri. Padyshim që është investuar me një impenjim maksimal nga të gjitha strukturat e shoqërisë, në realizim të asaj që ne e konsiderojmë primare në përditshmërinë e punës tonë; përkushtim ndaj klientëve, duke u siguruar atyre shërbim dhe cilësi gjithnjë në rritje. Me një histori tashmë mbi 28 vjecare në tregun e

sigurimeve, dhe qysh prej vitit 2016 pjesë e Grupit të sigurimeve EUROSIG, në një kombinim të eksperiencës profesionale dhe përshtatshmërisë në treg pas privatizimit, kemi mundur të ruajmë prej kaç vitesh klientët tanë ëbesnik, kemi rikthyer besimin në një pjesë të atyre të larguar, duke përmbushur kështu angazhimet dhe misionin e shoqërisë.

Jemi pjesë e një industrie sigurimesh me peshën dominuese të sigurimit të detyrueshëm (Raporti i sigurimeve të detyrueshme kundrejt atyre vullnetare në Shqipëri është 68% me 32%), fakt i cili ndikohet së tepërmi nga mjaft faktorë social-ekonomikë.

Pavarësisht politikave orientuese të shoqërisë të cilat kanë qenë drejt rritjes së tregut të sigurimeve vullnetare kundrejt atyre të detyrueshme, gjatë vitit 2018, ashtu si dhe vetë industria e sigurimeve në vend, INSIG vazhdon të ruajë një peshë deri në 20% të tyre ndaj totalit të portofolit të tij, fakt i cili bën që ndryshimi i këtij raporti të mbetet ende në prioritetet e tij për të ardhmen.

Niveli i të ardhurave të realizuara nga primet e sigurimet gjatë vitit 2018 për të gjithë tregun ishte rreth 15.7 miliard lekë, me një kontribut prej 6.94% të tyre nga Shoqëria INSIG, duke u renditur e gjashta në treg, ndërkohë konsideruar si grup kontributi në të ardhurat nga primet ishte 21.23% e volumit të përgjithshëm.

Sa i takon pagesave për dëme që u realizuan nga tregu i sigurimeve gjatë vitit 2018, 6.12% ishte kontributi i shoqërisë INSIG në totalin e përgjithshëm për dëme të paguara. Duhet theksuar këtu që rreth 102 milionë lekë janë kryer për praktika dëmsh që i takojnë Fondit të Kompensimit ose 9.7% të pagesave mbi totalin e tregut.

Referuar treguesve financiarë të shoqërisë, ata flasin për një vit të sukseshëm të saj, edhe pse rritja e të ardhurave nga primet krahasuar me një vit më parë nuk ka qenë e ndjeshme. Me një fitim prej rreth 40% më të lartë se ai i Vitit 2017, ndikuar më së shumti nga një menaxhim i mirë në drejtim të shpenzimeve operacionale të saj, duke i lënë hapësirë më të madhe pagesave për dëme, e konsideruar kjo si imazhi më i mirë që mund të prezantohet një shoqëri sigurimi.

Me një staf të kualifikuar, të dëshiruar për të ofruar më të mirën profesionalisht ndaj klientëve, me synime të qarta për atë çka e bën një shoqëri sigurimi të bëjë emër të mirë në treg, mbetem shpresëplot që viti 2019 do të ridimensionojë pozicionin e shoqërisë INSIG sh.a në treg.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

*Areta ÇUKO
Drejtoresh e Përgjithshme
INSIG sh.a*

Zhvillime kryesore të tregut të sigurimeve

- Gjatë vitit 2018 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 4.49%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 726,800 mijë lekë duke arritur shifrën 16,921,491 mijë lekë.
- Numri i kontratave arriti në 1,309,143 duke shënuar një rritje me 5.89% krahasuar me vitin 2017.
- Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 15,725,486 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 5.48% krahasuar me vitin 2017.
- Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 1,176,826 duke shënuar një rritje në masën 8.24% krahasuar me vitin 2017.
- Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 1,142,044 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 5.17% krahasuar me vitin 2017.
- Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 132,281 duke shënuar një ulje në masën 11.19% krahasuar me vitin 2017.
- Gjatë vitit 2018, janë paguar gjithsej 6,972,582 mijë lekë dëme ose 26.23% më shumë se gjatë vitit 2017.
- Numri i dëmeve të paguara në vitin 2018 është ulur me 261 dhe arriti shifrën 43,720 nga të cilat 41,940 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 1,780 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE



1. "Studentët për Qeverisjen e Mirë" ishte kryefjala e Forumit të mbështetur nga EUROSIG Group, Z. Arben Çejku dhe Fondacioni Konrad Adenauer. Presidenti i Eurosiga Group, Z. Kadri Morinaj, u kujdes personalisht për organizimin e këtij Forumi, i cili gjithnjë është gjendur përkrah studentëve dhe ideve të tyre në zhvillimin e vendit. Në fjalën e tij Z. Morinaj ndër të tjera theksoi: "E ardhmja është në dorën tuaj, por jo duke menduar vetëm parane, pasi paraja nuk është asgjë krahasuar me dijen. Nuk duhet të jetë vetëm karriera prioriteti juaj, por edhe të lini gjurmë në zhvillimin e Shqipërisë". Gjithashtu, studentes me esenë më të mirë, menjëherë pas përfundimit të studimeve iu ofrua të ishte pjesë e stafit Eurosiga.

2. Presidenti i EUROSIG Group, Z. Kadri Morinaj, si promotor i vlerave shqiptare anë e mbanë botës, ishte pjesë e grupit të pelegrinazhit të pritur nga Papa Françesku, të cilët u ftuan në Romë për të përkujtuar 550-vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Papa Françesku përshëndeti të gjithë shqiptarët në emër të lidhjes së lashtë të miqësisë dhe marrëdhënieve të përhershme me Vatikanin. Ati i Shenjtë vuri në dukje "historinë e lashtë dhe të lavdishme" të Shqipërisë, duke theksuar se ky popull është një pjesë integrale e Evropës, me kulturën e saj unike. Ai gjithashtu theksoi: "Sot, ne kujtojmë Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, një bir heroik i një populli të fortë dhe bujar, i cili mbrojtë me guxim vlerat shpirtërore dhe krishterimin, deri në atë pikë sa meritoi titullin Athleta Kristi. Gjergj Kastrioti forcoi identitetin kulturor shqiptar me veprat e tij, duke u bërë një simbol i padiskutueshëm i kohezionit dhe unitetit kombëtar".

3. Gjatë një takimi brezash në 25-vjetorin e hapjes së Fakultetit Ekonomik në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, Presidenti i Eurosiga-Insig, Z. Kadri Morinaj, ishte i ftuar për të mbajtur një fjalim përshëndetës për auditorët dhe stafin e pedagogëve, ku gjithashtu preku disa pika të rëndësishme lidhur me zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

4. Përgjegjësia sociale, promovimi i vlerave kulturore të vendit, të njerëzve të letrave shqipe dhe mbështetja për ata që kanë bërë histori apo atyre të artit, vazhdon të mbetet një nga parimet e Grupit EUROSIG dhe presidentit të tij, Z. Kadri Morinaj.

Sot në Tiranë, pranë Akademisë së Shkencave, u përrua busti i Egerem Çabejt, vepër arti e realizuar nga skulptori Hektor Dule, me mbështetjen financiare të EUROSIG dhe INSIG, si pjesë e grupit lider në sigurime dhe në veçanti, të Z. Morinaj!

5. EUROSIG Group vlerësohet në Bruksel me çmimin "Praktikat më të mira në biznes, 2018" EUROSIG vlerësohet me çmim evropian për praktikat më të mira në biznes në 2018 nga

Shoqëria Europiane për Kërkimin e Cilësisë (ESOR). Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve në Bruksel, presidenti i EUROSIG, Kadri Morinaj ka venë në pah vlerën e dyfishtë të këtij çmimi europian. Ai e cilësuar çmimin si një vlerësim për standartet europiane që ka arritur biznesi shqiptar, por edhe si një ogur të mirë në prag të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Eurosigg është vlerësuar midis kompanive të mëdha të Brazilit, Kinës, Japonisë apo vendeve të tjera të Bashkimit Europian. Ajo që ra në sy gjatë seancës së fjalimeve, ishte se ndryshe nga përfaqësuesit e kompanive të tjera, Kadri Morinaj ia kushtoi pothuajse të gjithë fjalimin e tij ndryshimit të Shqipërisë në 15 vitet e fundit dhe dëshirës për t'a parë atë sa më shpejt Shqipërinë pjesë të familjes europiane.



PRONËSIA MBI KOMPANINË

Në përputhje me Statutin e kompanisë, Neni 6, kapitali themeltar ,pas ndarjes së aktivitetit në 01.01.2017 në INSIG Jetë dhe INSIG sh.a., është 650.000.000 lekë (gjashtëqind e pesëdhjetë milion), i ndarë në 1,083 (njëmijë e tetëdhjetë e tre) aksione, me vlerë nominale 600,184.67 lekë secili. Gjatë vitit 2016, aksionet e shoqërisë iu shitën në masën 100% shoqërisë së sigurimeve Eurosig sh.a.

Këshilli Mbikqyrës :

Vasil Pilo – Kryetar

Rexhep Mejdani – Anëtar

Thanas Xhillari – Anetar




Organizimi i Kompanisë :

Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG SH.A.
Degët dhe numri i punonjësve


2018 Nr. Mesatar i punonjësve të INSIG sh.a. QENDER - 49

Shqipëri



Gjendja 31.12.2018		
Nr.rendor	Degët / Agjensitë	Nr. i punonjësve
1	BERAT	5
2	DIBER	3
3	DURRES	5
4	ELBASAN	5
5	FIER	3
6	GJIROKASTER	2
7	KAVAJE	2
8	KORCE	3
9	KUKES	3
10	LAÇ	1
11	LEZHE	3
12	LUSHNJE	3
13	POGRADEC	4
14	SARANDE	3
15	SHKODER	7
16	TIRANE 1	8
16 a	TIRANE 2	8
16 b	TIRANE 3	12
17	VLORE	6
	Total Degë/ Agjenci	86

Organigrama




TREGUESIT FINANCIARË

AKTIVITETI SIGURUES

Në vitin 2018 u shkruan 1,849,490, mijë lekë prime nga sigurimet e jo-jetës për INSIG sha duke përfshirë këtu edhe aktivitetin e degës Insig Kosove. Shpërndarja territoriale e primeve për vitin 2018 mbeti e pandryshuar krahasuar me një vit më parë: Shqipëri 59%, Kosovë 41%. Rreth 84% e primeve të shkruara bruto erdhi nga sigurimet motorrike, 14% nga sigurimet e pronës dhe 2% të shëndetit.


Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas territoreve

Prime të shkruara bruto	viti 2018	viti 2017
Shqipëri	59 %	59%
Kosovë	41 %	41%
Total	100%	100%



Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit për INSIG sh.a Shqiperi :

Lloji i produktit	viti 2018	viti 2017
Shëndet	2%	2%
Mjete motorrike	87%	86 %
Pasuri	11%	12 %
Total	100%	100%



DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2018 INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2018 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 354,913,696 lekë.

Dëme të paguara (në lekë)	
2018	354,913,696 lekë
2017	452,925,204 lekë

OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e INSIG sh.a

Opinion me rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta të INSIG sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e raportit tonë *Bazat për Opinionin me Rezervë*, pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Sikurse është paraqitur në shënimin 2, *Bazat e përgatitjes*, dhe shënimin 16 *Marrëdhënie me Degën Insig sh.a Kosovë ('Dega')*, të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta bashkëlidhur, Shoqëria nuk ka kryer kombinimin sipas secilës kategori të aktiveve dhe detyrimeve të saj si edhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me pasqyrat financiare të Degës së saj Insig Sh.a Kosovë. Marrëdhënia me Degën përfshin, fondet e transferuara për shtesa në kapitalin e Degës, humbjet e mbartuara dhe atë të vitit të Degës si edhe efektin e kursit të kembimit të vitit 2018. Nëse Shoqëria do të kishte kryer kombinim për secilën kategori të aktiveve dhe detyrimeve të saj si edhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me pasqyrat financiare të Degës, fitimi i vitit do të rritej me fitimin e vitit të Degës, si dhe detyrimi për Marrëdhënien me Degën Insig sh.a Kosovë, i cili paraqitet në këto pasqyra si një zë i vetëm në pasqyrën individuale të pozicionit financiar, do të shpërndahej në vlerat përkatëse të secilës kategori të aktiveve dhe detyrimeve.

2. Siç është prezantuar në shënimin 14, *Aktive Afatgjata Materiale*, Shoqëria ka rivlerësuar vlerën e drejtë për disa ndërtesa në vitin 2018 dhe 2017. Vlera e drejtë dhe e rikuperueshme e investimeve në ndërtesa dhe pasuri të paluajshme është përcaktuar nga një vlerësues i jashtëm pronash i cili ka përdorur metodën e krahasimit për vlerësimin e ndërtesave. Ne nuk mund të merrnim evidenca të përshtatshme dhe të mjaftueshme për tu mbështetur në vlerësimin me bazen e krahasueshmërisë të kryer nga Shoqëria për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe të rikuperueshme të ndërtesave. Si rrjedhim, ne nuk mund të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e drejtë dhe vlerën e rikuperueshme të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë si edhe për rezervën e rivlerësimit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

3. Sikurse është paraqitur në shënimin 2 d) Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) më anë të vendimit të Bordit numër 237, datë 26.11.2018, i ka kërkuar Shoqërisë anulimin e emetimit të huasë subordinuese të Eurosig Sh.a, Maqedoni në vlerën prej 981,672 euro, pasi ky transaksion nuk është në përputhje me vendimin nr. 149 datë 27.10.2017 të Bordit të AMF-së. Vendimi nr. 149 datë 27.10.2017 i Bordit të AMF-së parashtron masat administrative, ndër të tjera, ndalimin e transaksioneve me palet e lidhura dhe punonjësit dhe aksionaret si edhe hartimin e planit për përmirësimin e treguesve rregullatorë të Shoqërisë. Gjithashtu gjatë vitit 2018 parapagimet ndaj pronarit nuk janë ulur. Shoqëria ka ankimuar pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë vendimin nr. 237 datë 26.11.2018, të Bordit të AMF. Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë, me anë të vendimit numër 80-2019-715 datë 04.03.2019, ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 237 datë 26.11.2018, të Bordit të AMF dhe masat e marra sipas atij vendimi. AMF ka paraqitur ankimin ndaj vendimit 80-2019-274, datë 04.03.2019 pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë. Gjithashtu, Shoqëria prej 3 mujorit të tretë dhe të katërt nuk ka përfshirë, në përllogaritjet e treguesve rregullatore, humbjet e akumuluar deri më 31 dhjetor 2017 në vlerën prej 1,563,288 mijë lek, ku përfshihen edhe humbjet e mbartura të Degës Insig Kosova për vlerën prej 1,324,278 mijë lek, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përllogaritjen e këtyre treguesve gjatë vitit 2018 (Anekset Suplementare). Sikurse tregohet në shënimin 40, Ngjarje pas datës së raportimit, Banka Qëndrore e Kosovës më datë 26 prill 2019 ka revokuar licencën e Insig Dega Kosovë, ka njoftuar hapjen e procedurës së likuidimit të detyrueshëm si edhe ka caktuar një likuidator. Rrethanat e përshkruara më sipër tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Shoqëria nuk ka njohur ndonjë provizion lidhur me ndëshkimet që mund të ndodhin sa i përket mospërputhjeve me kërkesat rregullatore të lartpërmendura.

Për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafet e mësipërme ne nuk mund të përcaktojmë nëse rregullime në raportin e aktiveve për mbulim e detyrimeve të sigurimit do të ishin të nevojshme.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare për Qëllime të Veçanta. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale për qëllime të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kuadri Kontabël dhe Kufizimi në Përdorim dhe Shpërndarje


Pa modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, i cili përshkruan bazat e raportimit financiar. Këto pasqyra financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në mënyrë që Shoqëria të raportojë aktivitetin në territorin e Shqipërisë i cili është subjekt i supervizionimi të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti ynë është përgatitur vetëm për përdorim nga ana e Shoqërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") në Shqipëri, dhe nuk duhet të përdoret ose shpërndahet nga/në asnjë palë tjetër përveç Shoqërisë dhe AMF.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të aftësisë Paguese dhe Aktivët për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
30 prill 2019

Mediam Kodra, FCA



PASQYRE E HUMBJEVE DHE E TE ARDHURAVE TE TJERA PERMBLEDHESE TE INSIG SH.A.

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Prime te shkruara bruto	24	1,093,464,534	1,086,216,196
Ndryshimi neto ne rezerven e primeve te pafituara	15.1	41,428,432	21,912,916
Prime të shkruara neto		1,134,892,966	1,108,129,112
Prime te ceduara risiguruesve	30	-71,191,078	-72,814,270
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara për pjesën e risiguruesit	15.1	-5,224,267	-1,660,600
Prime të fituara neto		1,058,477,621	1,033,654,242
Të ardhura të tjera nga marrja në sigurim	27	11,672,606	11,999,320
Shpenzimet e demeve dhe te trajtimit te demeve	14	-293,311,476	-264,726,318
Shpenzimet e marrjes ne sigurim	28	-309,974,857	-296,984,095
Shpenzime administrative	29	-397,976,038	-473,848,403
Humbje operative		68,887,855	10,094,746
Të ardhurat financiare	26	5,323,329	69,208,056
Të ardhura/(humbje) nga kurset e këmbimit, neto	26	-33,809,611	-49,945,601
Të ardhura financiare neto		(28,486,282)	19,262,455
(Humbja)/fitimi para tatimit		40,401,573	29,357,201
Tatimi mbi fitimin			
Humbja e vitit	31	-8,041,123	-6,321,833
Të ardhura përmbledhëse të tjera		32,360,451	23,035,368
Rezerva përktimi			
Tatimi i shtyrë nga rezerva e katastrofës			
Totali i (humbjes)/të ardhurave përmbledhëse të vitit		32,360,451	23,035,368

PASQYRE E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL VITI 2018

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva rivlerësimi	Rezerva për dëme	Rezerva të tjera	Rezerva konvertimi	Fitimi i Pashpërdare	Totali
	Lek	Lek	Lek	Lek	Lek	Lek	Lek
Gjendja më 1 janar 2017	1,020,000,000	180,626,537	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,668,995,821)	635,747,611
Zbritje kapital per ndarjen e aktivitetit INSIG Jete	(370,000,000)	-	-	-	-	-	(370,000,000)
Zbritje fitime te akumuluar per INSIG Jete	-	-	-	-	-	(16,644,821)	(16,644,821)
Ulje e rezervave nga shitja e aktiveve fikse	-	(35,980,012)	-	-	-	-	(35,980,012)
Rritje e rezervave te rivleresimit nga rivleresimi pronave	-	27,001,110	-	-	-	-	27,001,110
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	23,035,279	23,035,279
Fitime neto per periudhen, Dega Insig sh.a Kosove	-	-	-	-	-	122,352,312	122,352,312
Gjendja më 31 dhjetor 2017	650,000,000	171,647,635	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,540,253,051)	385,511,479
Gjendja më 1 janar 2018	650,000,000	171,647,635	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,540,253,051)	385,511,479
Ulje e rezervave nga shitja e aktiveve fikse	-	(18,912,540)	-	-	-	-	(18,912,540)
Rritje e rezervave te rivleresimit nga rivleresimi pronave	-	126,949,548	-	-	-	-	126,949,548
Rezerve rivleresimi nga kursi i kembimit i deges Insig Kosovo	-	-	-	-	-	-	150,708,040
Humbje/Fitime neto per periudhen, Dega Insig sh.a Kosove	-	-	-	-	-	150,708,040	(63,220,923)
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	(63,220,923)	(63,220,923)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,420,405,483)	613,396,055

PASQYRE E FLUKSIT TE PARASE 31 DHJETOR 2018

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

Fluksi i parase nga aktivitetet operative	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Fitimi pas tatimit	32,360,451	23,035,368
Axhustime per :		
Interesa nga investimet financiare	(5,323,329)	(69,208,056)
Amortizimi	29,118,521	19,643,375
Humbje nga nxjerrjet jashte perdorimit te aktive fix	1,927,022	98,541,739
Efekte nga konvertimi	-	-
Rritje/ulje ne cash per njesi kontrolluese	(92,626,872)	-
Rritje/ulje ne asetet e risiguruesit	(82,207,895)	108,302,703
Rritje/ulje ne llogarite e arketueshme nga risiguruesi	-	135,731,877
Rritje/ulje ne llogarite e arketueshme per primet	(6,864,998)	14,542,696
Rritje/ulje per kostot e shtyra te marrjes ne sig (DAC)	35,670,194	(58,008,618)
Ndryshime ne taksat e parapaguara,tatim fitimi	28,879,312	18,892,500
Rritje/ulje per rezervat teknike te demeve	114,341,727	(349,603,854)
Rritje/ulje per rezervat teknike te primeve	(41,428,432)	(106,718,447)
Rritje/ulje ne detyrimet e tjera	(122,277,639)	(272,776,247)
Rritje/ulje ne taksat e shtyra	3,318,959	1,584,511
Rritje/ulje ne aktivet e tjera	226,543,171	(153,178,796)
Rritje/ulje ne llogarite te pagueshme per risiguruesin	9,366,294	108,224
Interesa te arketuara	5,323,329	69,208,056
Flukset e arkes gjeneruar nga aktiviteti operativ	136,119,816	(519,902,969)
Flukset e arkes nga aktiviteti investues		
Blerje aktivesh te qendrueshme te trupezuara	-133,054,647	-398,541,067
Rritje/ulje nga investimet ne depozita	6,573,000	-325,952,328
Blerje/maturim ne bono thesari	0	1,231,661,450
Fluksi i arkes nga aktiviteti investues	(126,481,647)	507,168,054
Fluksi i arkes i gjeneruar	9,638,169	-12,734,915
Mjete monetare ne arke dhe banke ne fillim te periudhes	8,527,044	21,261,958
Mjete monetare ne arke dhe banke ne fund te periudhes	18,165,213	8,527,044

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më poshtë pëfshihet një informacion përmbledhës nga pasqyrat financiare të audituara

Deklaratë e përputhjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, me përjashtim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe investimeve të mbajtura për tregtim të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë të prezantuara në Lekë, monedha Shqiptare, që është dhe monedha funksionale e Grupit.

Baza e Konsolidimit

Filialet

Filialet janë ato entitete të cilat janë të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë, në mënyrë direkte dhe indirekte, të qeverisë politikën financiare dhe operative të një entiteti si dhe të sigurojë përfitime nga aktiviteti i tyre. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të ushtrimit të kontrollit deri në datën kur ky kontroll mbaron.

Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politika dhe procedura për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përket riskut të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet.

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta dhe të plotësojnë kërkesat e Shoqërisë përsa i përket kriterëve për Risigurimet. Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat.

Analiza e sensitivitetit

Tabela e mëposhtme detajon sensitivitetin e Shoqërisë ndaj rritjes dhe uljes së Lekut përkundrejt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të riskut nga kurset e këmbimit për personelin e lartë menaxherial dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Në cdo analizë sensitiviteti paraqitet ndikimi i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, në analizën e sensitivitetit. Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

		2018	2017
EUR rritet me 10 % kundrejt Lekut EUR bie me 10 % kundrejt Lekut	Fitim	19,810,617	9,010,281
	Humbje	(19,810,617)	(9,010,281)
USD rritet me 10 % kundrejt Lekut USD bie me 10 % kundrejt Lekut	Fitim	21,792,154	15,814,135
	Humbje	(21,792,154)	(15,814,135)
GBP rritet me 10 % kundrejt Lekut USD bie me 10 % kundrejt Lekut	Fitim	639,820	271,297
	Humbje	(639,820)	(271,297)

Rreziku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti. Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 Shoqëria nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesmbajtëse dhe as instrumenta me norma të ndryshueshme, por përqendrimin më të madh të rrezikut të normës së interesit e ka lidhur me depozitat me afat dhe bonot e thesarit, të cilat kanë maturitet 1 deri në 2 vjet.

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkalluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria

ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Shoqëria administron riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Rreziku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti. Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 Shoqëria nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesmbajtëse dhe as instrumenta me norma të ndryshueshme, por përqendrimin më të madh të rrezikut të normës së interesit e ka lidhur me depozitat me afat dhe bonot e thesarit, të cilat kanë maturitet 1 deri në 2 vjet.

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar ibrendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkalluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Shoqëria administron riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Supozime dhe sensitiviteti

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Grupi e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur

supozimet e tjera të pandryshuara (në '000 Lek):

Raporti i dëmeve	Impakti	2018	2017
5 % rritje ne raportin e demeve	Humbje	(14,665,574)	(13,236,316)
5 % renie ne raportin e demeve	Fitim	14,665,574	13,236,316
Raporti i shpenzimeve			
5% rritje ne raportin e shpenzimeve	Humbje	(35,852,261)	(35,466,375)
5% renie ne raportin e shpenzimeve	Fitim	35,852,261	35,466,375
Raporti i kombinuar			
5 % rritje ne raportin e kombinuar	Humbje	(50,517,834)	(48,702,691)
5 % renie ne raportin e kombinuar	Fitim	50,517,834	48,702,691

Treguesit e mjaftueshmerise se kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike.

Bazuar ne Ligjin nr 52 date 22/05/2014, i ndryshuar dhe rregulloren nr 19/2015 "Mbi aktivet e lejuara dhe investimet e aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike" shoqeria INSIG rezulton me aktive ne mbulim te Provigjoneve teknike mbi 100% më 31.12.2018. Bazuar ne Ligjin nr 52 date 22/05/2014, i ndryshuar dhe rregullores nr 87/2016 "Mbi elemente e zbritshem ne llogaritjen e kapitalit" shoqeria INSIG sha zoteron aftesi paguese dhe likuiditet më 31.12.2018.

Vlerat e treguesit te mjaftueshmerise se kapitalit, treguesit te likuiditetit dhe treguesit te aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike mund ti konsultoni edhe ne raportin e shoqerise audituese mbi pasqyrat financiare per periodhen deri me 31.12.2018, te pergatitur sipas SNRF (pjesë e ketij raporti pika 8)



RAPORT (Përmbledhje)

Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për Vitin 2018

I. Baza ligjore që rregullon veprimtarinë e AB në shoqërinë INSIG sha

- Ligji 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Rregullore e AMF nr. 153/2015 "Për veprimtarinë e njësisë së AB dhe Komitetit të Auditimit në Shoqëritë e Sigurimit".
- "Karta e Auditimit të Brendshëm në INSIG sha "miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.18 date 12.12.2017, Rregullore "Për veprimtarinë e AB në INSIG sha", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.1 date 21.03.2018.
- Veprimtaria e AB është përshtatur me kërkesat ligjore si dhe është monitoruar dhe mbikëqyrur në vazhdimësi nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Komiteti i Auditimit, si (Shqyrtimi i raporteve të auditimit, miratimi i rekomandimeve, miratimi i planit të auditimeve, etj.).

II. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018

- Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 është ushtruar mbështetur, në planin vjetor të auditimeve të vitit 2018, miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 8, date 15 nëntor 2017.
- Për vitin 2018, AB ka kryer gjithsej 15 misione auditimi duke realizuar planin e auditimit të miratuar nga KA dhe KM.
- Klasifikimi i auditimeve të realizuara sipas nivelit të riskut:
- Me risk të lartë 4 auditime
- Me risk të mesëm 11 auditime.

III. Konstatimet dhe gjetje nga auditimi i brendshëm për vitin 2018:

Konkluzione të Përgjithshme:

- Strukturat e shoqërisë INSIG sha, rrjeti i shitjes, Degët dhe Departamentet gjatë vitit 2018, në përgjithësi kanë ushtruar veprimtarinë në përputhje me kornizën ligjore si të Ligjit të Sigurimeve dhe Risigurimeve dhe rregulloreve të AMF (Marraja në Sigurim, Trajtimi dëmeve, menaxhimi i rrisqeve, etj)
- Strukturat përkatëse si Degët dhe Departamentet në përgjithësi kanë angazhimin dhe përgjegjësinë për zbatimin e politikave të aksionarit, të rregulloreve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe udhëzimeve dhe urdhrave të menaxhmentit të kompanisë.
- Në disa raste janë konstatuar mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Konstatimi në kohë i problematikave dhe zbatimi i rekomandimeve të AB për eliminimin e mangësive, këndikuar në parandalimin e parregullsive në administrimin

e rrjetit të shitjes, administrimin e policave, menaxhimin e shpenzimeve, procedurat ligjore, trajtimi dhe veprimet, etj..

1. Konstatime dhe rekomandime lidhur me sistemin e marrjes në sigurim

- Vlerësojmë se në përgjithësi janë zbatuar rregulloret dhe kriteret e marrjes në sigurim për administrimin e policave, rakordimet mujore me degët, etj.
- Shitja TPL, Kartoni Jeshil, Kufitare, etj., është realizuar në programin e shitjeve on-line, konformë udhëzimit të AMF, udhëzimit të administrimit të policave dhe kushteve të përgjithshme të marrjes në sigurim.
- Departamenti i Marrjes në Sigurim, duhet të bëjë një punë më të programuar për inspektime periodike me qëllim evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave që ka rrjeti i shitjes.
- Në total, për 2018 komisionet e ndërmjetësimit rezultojnë me ulje me 3.7% në krahasim me 2017.
- Degët e audituara, nuk kanë performancë të mirë në sigurimet vullnetare, pasi raporti i sigurimeve të detyrueshme me sigurimet vullnetare është përgjithësisht 98 % sigurimi detyrueshëm dhe deri 2% sigurimet vullnetare.

Nga AB, Është rekomanduar që, Departamentet në qendër, kryesisht Dep. Marrjes në Sigurim në bashkëpunim me degët e INSIG çdo 3/mujor të analizojnë rezultatet e shitjes duke vlerësuar performancën e agjenteve dhe punonjësve, kryesisht me volumin e shitjeve vullnetare.

Nga inventarizimi fizik i policave të sigurimit kryer në rrjetin e shitjes për degët e audituara, rezulton se gjendja fizike e policave të sigurimit është e njëjta me gjendjen sipas sistemit të shitjeve (programi), pra nuk kanë rezultuar diferenca.

Konstatohet se, Degët në rrethe nuk kanë informacion periodik për demet. Prandaj është rekomanduar që, Degët e INSIG shpesh dhe Departamenti i Marrjes në Sigurim, në vazhdimësi duhet të marrin informacion për demet si dhe të analizojnë treguesit e dëmeve të paguara, demet pezull, si për demet e ndodhura në territorin e degës dhe demet sipas policave të lëshuara nga dega përkatëse, me qëllim vlerësimin dhe minimizimin e risqeve të marrjes në sigurim dhe analizën e rezultatit teknik të produkteve edhe në shkallë dege.

2. Konstatime dhe rekomandime për sistemin e Financës

- Nga verifikimi me zgjedhje të praktikave të pagesave, përgjithësisht janë zbatuar rregullorja "Për dokumentacionin e kryerjes së pagesave në INSIG shpesh", dhe Rregullorja "Për menaxhimin e zërave të shpenzimeve në INSIG shpesh" të miratuara nga KM.
- Në disa raste ka patur probleme të menaxhimit të shpenzimeve, ka munguar kontrolli paraprak i dokumentacionit të pagesave kryesisht për blerjet, demet dhe në disa raste ka munguar ndjekja e zërave të shpenzimeve sipas buxhetit paraprak të miratuar.
- Kontabiliteti i INSIG (qendër dhe dege) mbahet në programin financiar EDUSOFT.

Akoma nuk është integruar me programin e financës regjistrimi i pagesave të dëmeve dhe të nxjerrjes së raporteve të kërkuara (pra nuk është integruar programi dëmeve me financën).

- Për zërat e shpenzimeve, AB ka rekomanduar që: Të analizohen të gjithë zërat e shpenzimeve administrative dhe të merren masa për uljen e kostove kryesisht në zërin paga personeli, shpenzime për qera , etj.

3. Konstatime nga auditimi i sistemit të përputhshmërisë (Departamenti Ligjor)

- Në përgjithësi çështjet gjyqësore janë ndjekur dhe mbrojtur nga i njëjti jurist në të gjitha shkallët e gjykimit , pra nuk janë angazhuar ekspert të fushave përkatëse që ka kompania si vlerësues të dëmeve, mjeku i kompanisë, etj.
- Në rastet e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve për dëmshpërblimet, janë zbatuar kërkesat e ligjit 52/2014 dhe rregulloret e brendshme të INSIG lidhur me zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve për dëmshpërblimet.
- Është rekomanduar që, Shqyrtimi dhe miratimi përfundimtar i marrëveshjes dhe vlerës së dëmshpërblimit me pajtim të bëhet me komision , për të vlerësuar mbylljen me marrëveshje të dëmshpërblimit.
- Marrëveshjet jashtëgjyqësore për rastet kur vlera e dëmshpërblimit dakortësohet në fazën e trajtimit administrativ të praktikës së demit, të noterizohen.

4. Konstatime nga auditimi i sistemit të Dëmeve

- Në përgjithësi në trajtimin e dëmshpërblimit të dëmeve TPL , është zbatuar Rregullorja për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga Kontrata e Sigurimit të Detyrueshëm në Sektorin e Transportit , Nr. 34 datë 12.11.2015 si dhe rregullorja 53 e AMF, si në plotësimin e dokumentacionit të praktikave, janë respektuar nivelet e kompetencave në miratimin e dëmeve, etj.
- Nga verifikimi i regjistrimit të dëmeve të vitit 2017, si ato të paguara dhe demet pezull, rezulton se në përgjithësi demet hidhen në kohë reale brenda ditës së punës ose brenda 24 –72 orëve të regjistrimit të praktikës, në programin online.
- Në vlerësimin e dëmshpërblimit për demin material , orët e punës kanë tendencën të llogariten në vlerën maksimale të tyre edhe pse në disa raste nuk korrespondojnë me kategorizimin e mjetit në grup.
- Vlera e dëmeve të paguara në vitin 2017 janë rakorduar me kontabilitetin.
- Në përgjithësi janë zbatuar afatet ligjore të miratimit dhe pagesës së vlerës së dëmshpërblimit. Por, në disa raste miratimi i demit është bërë mbi kufirin kohor sipas rregullores. Kjo pasi klientët nuk sjellin dokumentet në kohën e duhur, kryesisht janë rastet e dëmeve Shëndetësore.

Rekomandime te dhëna :

- Per demet kasko, procesverbali i policisë duhet te jete i detyrueshëm për rastet e përplasjeve mjet me mjet (kur pala tjetër është e identifikuar) si dhe për raste dëmsh me vlere mbi limitin e parashikuar (mbi 100,000 leke).
- Per sigurimin kasko, fotografitë e marrjes ne sigurim dhe pagesa paraprake e primit nuk duhet te shmangen si kërkesa ne trajtimin e demit, këto kërkesa te mbeten ne kushtet e marrjes ne sigurim Kasko dhe ne rregulloren e trajtimit te dëmeve .
- Ne rastet kur nga procesverbalet e policisë rezulton fajtor edhe përfituesi i dëmshpërblimit, te behet ndarja e fajësisë ose te propozohet investigimi i rastit.
- INSIG sha. operon me marrëveshje ligjërish te rregullta me disa servise ne treg, pavarësisht kësaj ne çdo rast dërgimi i një mjeti ne servis duhet te behet me autorizim paraprak te Drejtorit te Departamentit dhe pëlqim te klientit.

III. Plani e Auditimit dhe Prioritet për vitin 2019:

- Plani i auditimit për vitin 2019 dhe strategjik 2019-2021 është miratuar me vendim te Këshillit Mbikëqyrës nr. 15 date 13 dhjetor 2018.
 - Gjithsej do kryhen 15 auditime (Departamente, Dege, etj.).
 - Niveli i vlerësimit të riskut për 15 objektet qe auditohen është : - objekte dhe fusha me risk të larte 5 - me risk të mesëm 10 objekte.

Raporti “Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për Vitin 2018” është miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr.5, date 24 maj 2019 dhe sipas kërkesave ligjore është depozituar brenda afatit ligjor edhe ne Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).